



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E SHËNDETËSISË  
DHE MBROJTJES SOCIALE  
SEKRETARI I PËRGJITHSHËM

Nr. \_\_\_\_ / \_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_ . \_\_\_\_ . 2022

**Shtojca 13**

**[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]  
FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT  
(PAS PROCESIT TË ANKIMIT)**

[ \_\_\_\_ . \_\_\_\_ . 2022 ]

Drejtuar: **COMPANY RIVIERA 2008 Shpk, me NIPT K81716011V dhe me adresë Tiranë, Kamëz, Rruga Nacionale Kamëz-Fushë Krujë, Kthesa e Valiasit Nr.1, në zonë kadastrale 2066, Nr.Pasurie 62/35.**

\* \* \*

Procedura e prokurimit: e hapur - prokurim me mjete elektronike – punë publike.

Numri i procedurës / referenca e Lotit: **REF-23748-04-01-2022, Loti 1 - REF- 23750-04-01-2022.**

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: **“Rikonstruksion i qendrave shëndetësore (viti 2022-2023)”** me fond limit 103,918,778.40 (njëqind e tre milion e nëntëqind e tetëmbëdhjetëmijë e shtatëqind e shtatëdhjetë e tetë .40) Lekë pa TVSH, ndarë në lote:

**Lot.1 “Rikonstruksion i disa QSH- ve në rajonet Tiranë dhe Shkodër (13 objekte)”** me fond limit 65,694,983.16 (gjashtëdhjetë e pesë milion e gjashtëqind e nëntëdhjetë e katër mijë e nëntëqind e tetëdhjetë e tre .16) lekë pa TVSH.

Kohëzgjatja e kontratës/marrëveshjes kuadër ose afati për zbatimin e saj:

Lot.1 “Rikonstruksion i disa QSH- ve në rajonet Tiranë dhe Shkodër (13 objekte)” – 8.5 muaj nga data e nënshkrimit të proces-verbalit të fillimit të punimeve (per objektin e pare). Publikimet e mëparshme (nëse është rasti): **Nuk ka**

Buletini i Njoftimeve Publike: Buletini Nr. 46 datë 11 Prill 2022.

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar ne kosto

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim

Me anë të këtij Njoftimi ju informojmë se, në këtë procedurë kanë marrë pjesë Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

<b>1</b>	<b>NIKA shpk me NIPT J76705047U dhe adresë Shkodër Lagjia Vasil Shanto, Bulevardi Skenderbeu, godinë 8-katëshe, kati i I-rë, Zona kadastrale 8593, nr.pasurie 5/587”, ofertuar me vlerën 44,589,114.88 lekë pa TVSH.</b>
<b>2</b>	<b>BOE 2Z KONSTRUKSION shpk me NIPT J63229466K dhe adresë Fier Roskovec Strum Fshati Suke i sipërm, Nr 2, Rruga Strum - Sukë, Km 3, Lagjia Zoga, I.C.C GROUP shpk me NIPT L51308006A dhe adresë Tiranë Njësia bashkiake Nr.4, Rruga 5 Maji, Kompleksi AREELA, Pallati</b>

	2, Shkalla 1, Apartamenti 21 dhe <b>VISCONS GROUP shpk</b> me NIPT <b>L96513208E</b> dhe adresë Vlorë Lagjja 28 Nentori, Pallati Invest, kati 1, <i>përfaqësues i këtij bashkimi është OE "2Z KONSTRUKSION" shpk me NIPT J63229466K</i> , ofertuar me vlerën <b>51,884,540.50 lekë pa TVSH.</b>
3	<b>S I R E T A 2F shpk</b> me NIPT <b>K51501008J</b> dhe adresë Kompleksi "SIRETA 2F", Lagjja Babrru Fushë, Njësia Administrative Paskuqan, Tiranë 1047, ofertuar me vlerën <b>52,222,222.00 lekë pa TVSH.</b>
4	<b>GLAVENICA shpk</b> me NIPT <b>K17710805A</b> dhe adresë Fier Ballsh Lagjja "5 Shkurti", Bulevardi "4 Heronjtë", godina nr.2, apartament nr.3, kati.4 ofertuar me vlerën <b>54,427,193.00 lekë pa TVSH.</b>
5	<b>K A C D E D J A shpk</b> me NIPT <b>K51712017A</b> dhe me adresë Tirane Rruga Don Bosko, Pallati Meld, Kati i dytë, 1001, ofertuar me vlerën <b>55,680,906.90 lekë pa TVSH.</b>
6	<b>COMPANY RIVIERA 2008 shpk</b> me NIPT <b>K81716011V</b> dhe me adresë Tirane Kamëz Rruga Nacionale Kamëz-Fushë Krujë, Kthesa e Valiasit Nr.1, në zonë kadastrale 2066, Nr.Pasurie 62/35 ofertuar me vlerën <b>55,835,085.00 lekë pa TVSH.</b>
7	<b>STERKAJ shpk</b> me NIPT <b>J68310708M</b> dhe adresë Tiranë Njësia Bashkiake Nr. 5, Blv. "Bajram Curri", mbrapa pallateve Agimi, Pallati 7/1B, Kati 2, ofertuar me vlerën <b>59,045,627.22 lekë pa TVSH.</b>
8	<b>AVDULI shpk</b> me NIPT <b>J66703306O</b> dhe adresë Vlorë Lagjja 10 Korriku, Rruga Perlat Rexhepi, Objekt 3-katesh nr.4, Kati 1 ofertuar me vlerën <b>60,389,001.00 lekë pa TVSH.</b>
9	<b>PEPA GROUP shpk</b> me NIPT <b>L42215009L</b> dhe me adresë Tiranë Kashar Autostrada Tiranë Durrës km 6, Zona Kadastrale nr.2105, Nr Pasurie 1168/13, ofertuar me vlerën <b>61,207,869.93 lekë pa TVSH.</b>
10	<b>INA shpk</b> me NIPT <b>J61814009W</b> dhe me adresë Tiranë Rruga Besim Imami, Myslym Shyri, Mbrapa Karburantit ofertuar me vlerën <b>61,246,704.00 lekë pa TVSH.</b>
11	<b>AURORA KONSTRUKSION shpk</b> me NIPT <b>K02017003I</b> dhe me adresë Tiranë Bulevardi Zogu i Parë, Pallati pranë Fakultetit të Shkencave, kati 2, ofertuar me vlerën <b>62,915,725.00 lekë pa TVSH.</b>
12	<b>JUNIK shpk</b> me NIPT <b>J68007522L</b> dhe me adresë Lezhë Lagjja SMT, Ndërtesë 2-Katëshe, kati 2, pranë Drejtorisë Shërbimit Pyjor Lezhë, ofertuar me vlerën <b>63,116,553.00 lekë pa TVSH.</b>
13	<b>DON JURGE shpk</b> me NIPT <b>K33005405Q</b> dhe adresë Fier LEVAN, <b>pa ofertë ekonomike.</b>

\* \* \*

Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:

1. **NIKA shpk** me NIPT **J76705047U** dhe adresë Shkodër Lagjja Vasil Shanto, Bulevardi Skenderbeu, godinë 8-katëshe, kati i I-rë, Zona kadastrale 8593, nr.pasurie 5/587", ofertuar me vlerën **44,589,114.88 lekë pa TVSH.**

#### **Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:**

- Nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur nga ky operator u konstatua ka ndryshime të njësive matëse të llogaritjes së cmimit njësi të ofertës ekonomike nga njësia matëse e llogaritjes e publikuar në DT.

Përkatësisht:

		<b>OBJEKTI: Ambulanca Zall Dajt, Komuna ZallBastar</b>		
<b>Nr</b>	<b>Nr.Art</b>	<b>PERSHKRIMI I PUNIMEVE</b>	<b>NJESIA e ofertuar</b>	<b>NJESIA në DT</b>
		<b>A. PUNIME NDERTIMI</b>		
		<b>I. Punime prishje</b>		
2	An	Prishje mur guri ne lartesi	m2	m3
4	An	Heqje dyer	ml	m2

6	An	Heqje dritare	m3	m2
---	----	---------------	----	----

		<b>OBJEKTI: Ambulanca Vorrozen</b>		
<b>Nr</b>	<b>Nr.Art</b>	<b>PERSHKRIMI I PUNIMEVE</b>		
			<b>NJESIA e ofertuar</b>	<b>NJESIA në DT</b>
		<b>A. PUNIME NDERTIMI</b>		
		<b>I. Punime prishje</b>		
4	2.37/5a	Transport dheu me auto deri 5.0 km	m2	m3
		<b>OBJEKTI: Ambulanca e Fshatit Bicaj (Objekti ekzistues)</b>		
<b>Nr</b>	<b>Nr.Art</b>	<b>PERSHKRIMI I PUNIMEVE</b>		
			<b>NJESIA e ofertuar</b>	<b>NJESIA në DT</b>
		<b>B. INSTALIMET HIDROSANITARE</b>		
		<b>I. Punime hidrosanitare</b>		
7	AN proj	FV kontravalvol 1/2" ne hyrje te depozites se ujit	ml	cope

		<b>OBJEKTI: QSH Lekbibaj, Tropoje</b>		
<b>Nr</b>	<b>Nr.Art</b>	<b>PERSHKRIMI I PUNIMEVE</b>		
			<b>NJESIA e ofertuar</b>	<b>NJESIA në DT</b>
		<b>A. Punime Ndertimi</b>		
		<b>1. Punime Catie dhe Tarrace</b>		
3	An pro	Prishje tavane me derase ose materiale te tjera dhe riberja me karton xhes të zakonshëm	m3	m2

Ndryshimet e bëjnë ofertën e këtij operatori të pa krahasueshme dhe të pamundur në vendosje në kushte të barabarta me operatorët e tjerë pjesëmarrës në këtë procedurë.

Kjo në zbatim të ligjit Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” neni 2 pika d:

*Qëllim i këtij ligji është:*

- të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;
- të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;
- të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;
- të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;

dhe të nenit 3 pika 1 të këtij ligji:

*Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale.*

Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se zotërojnë reputacionin, besueshmërinë dhe përvojën e duhur, për të zbatuar kontratën objekt prokurimi, si edhe janë të detyruar të përgatisin oferta, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit, në mënyrë që edhe vlerësimi të bëhet në përputhje me këtë dokumentacion, pasi **ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme.**

**Për sa më lart oferta e operatorit NIKA shpk nuk kualifikohet.**

2. BOE: 2Z KONSTRUKSION shpk me NIPT J63229466K dhe adresë Fier Roskovec Strum Fshati Suke i sipërm, Nr 2, Rruga Strum - Sukë, Km 3, Lagjja Zoga, **I.C.C GROUP shpk** me NIPT **L51308006A** dhe adresë Tiranë Njësia bashkiake Nr.4, Rruga 5 Maji, Kompleksi AREELA, Pallati 2, Shkalla 1, Apartamenti 21 dhe **VISCONS GROUP shpk** me NIPT **L96513208E** dhe adresë Vlorë Lagjja 28 Nentori, Pallati Invest, kati 1, me *përfaqësues të këtij bashkimi OE “2Z KONSTRUKSION” shpk me NIPT J63229466K*, ofertuar me vlerën **51,884,540.50 lekë pa TVSH.**

**Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:**

- Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga ky BOE për sa i përket dorëzimit të Sigurimit të Ofertës sipas **Seksioni 3: Informacione juridike, ekonomike, financiare dhe teknike**, të DST, rezulton se sigurimi i ofertës nuk është paraqitur sipas kërkesave të Autoritetit Kontraktor në dokumentat e tenderit.  
Bashkimi i Operatorëve ka dorëzuar në dokumentat e paraqitura për **Lot.1 “Rikonstruksion i disa OSH- ve në rajonet Tiranë dhe Shkodër (13 objekte)”**, Formularin e Sigurimit të Ofertës për **Lot.2 “Rikonstruksion i disa OSH- ve në rajonet Elbasan dhe Vlorë (12 objekte)”**, **(i cili është gjithashtu i një vlere më të vogël në krahasim me vlerën e sigurimit të kërkuar për Lotin 1).**

Në bazë të vendimit Nr. 285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin E Rregullave Të Prokurimit Publik”, Neni 30, Sigurimi i ofertës, pika 3 përcaktohet:

***3. Autoriteti/enti kontraktor duhet të specifikojë në dokumentet e tenderit vlerën e sigurimit të ofertës, e cila është sa 2% e vlerës së fondit limit. Në dokumentet e tenderit duhet të parashikohet një periudhë vlefshmërie, bazuar në kohëzgjatjen e mundshme të procedurës. Sigurimi i ofertës duhet të jetë i vlefshëm gjatë gjithë kësaj periudhe.***

Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. **Si rrjedhojë, Formulari i Sigurimit të Ofertës nuk do të pranohet.**

- Për plotësimin e kriterit për punë të ngjashme operatorët kanë paraqitur realizimet e disa punimeve të ngjashme. Sipas kontratës së bashkëpunimit të dorëzuar nga ky BOE rezulton se:

Pjesëmarrja në bashkëpunim e këtyre operatorëve është:

- 2Z KONSTRUKSION shpk 47% e pjesëmarrjes në bashkëpunim,
- I.C.C GROUP shpk 47% e pjesëmarrjes në bashkëpunim,
- VISCONS GROUP shpk 6% e pjesëmarrjes në bashkëpunim.

Lidhur me përmbushjen e kriterit për punë të ngjashme sipas përqindjes në bashkëpunim, I.C.C GROUP shpk nuk plotëson vlerën e kontratave, pasi në SPE ka dorëzuar dokumentacionin si më poshtë:

- Dokumentin e ngarkuar – Pune e ngjashme Salla e Keshillit (Ndertimi i sherbimit me nje ndalese (One stop Shop) + Salla e Keshillit, Bashkia Patos).

- Dokumentin e ngarkuar – Rikonstruksion Fusha e Sportit – ICC.pdf (Rikonstruksioni fushes se sportit Selenice “Bashkia Selenice”).

- Dokumentin e ngarkuar – Pune e ngjashme Banesa Sociale Patos (Rikonstruksion ish kopshti ne “Lagjen e Re” ne banesa sociale, Bashkia Patos).

- Dokumentin e ngarkuar – Adaptim\_banesa\_sociale\_Patos (Adaptim i ish-Godines se Kualifikimit te Lagjja e Re ne Banesa Sociale, Bashkia Patos).

Mbështetur në praktikën e Komisionit të Prokurimit Publik në vendimin Nr. 611/2020 i datës 30.12.2020, sqarohet se: *“Komisioni gjykon se krahasueshmëria e kontratave nëse janë të ngjashme nuk ka të bëjë vetëm me natyrën e kontratës nëse ajo është një kontratë pune publike, por duhet parë në lidhje me të gjithë zërat konkretë të punimeve të kryera. Në rastin konkret, pavarësisht se kontratat janë punë publike me objekte të gjëra veprimtarie, në zbatimin e këtyre kontratave nuk ka patur punime të ngjashme me një pjesë të rëndësishme të punimeve objekt prokurimi. Gjithashtu, KPP gjykon se për autoritetin kontraktor është e rëndësishme të provohet që operatori ekonomik zotëron eksperiencat e mëparshme të ngjashme me punimet objekt prokurimi, por edhe në përputhje me volumin e përcaktuar në dokumentat e tenderit”*.

Sipas ndarjes së bashkëpunimit operatori **I.C.C GROUP shpk** ka paraqitur pune të ngjashme në një vlerë prej 12,696,869.52 lekë, ku sipas përqindjes së bashkëpunimit duhet të kishte realizuar punë të ngjashme në një vlerë prej 15,438,321.04 lekë.

Në bazë të Kreut XI, vendimit Nr. 285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin E Rregullave Të Prokurimit Publik”, Neni 88, Bashkimi i operatorëve ekonomikë, pika 3 përcaktohet:

*3. Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat e parashikuara në nenin 76, të LPP-së, dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat për kualifikim: ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike, duhet të **përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje.***

**Për sa më lart oferta e BOE 2Z KONSTRUKSION shpk, I.C.C GROUP shpk, dhe VISCONS GROUP shpk nuk kualifikohet.**

**3. S I R E T A 2F shpk** me NIPT **K51501008J** dhe adresë Kompleksi “SIRETA 2F”, Lagjja Babrru Fushë, Njësia Administrative Paskuqan, Tiranë 1047, ofertuar më vlerën **52,222,222.00 lekë pa TVSH.**

**Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:**

- Nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur nga ky operator u konstatua ka ndryshime të njësia matëse të llogaritjes së cmimit njësi të ofertës ekonomike nga njësia matëse e llogaritjes e publikuar në DT.

Përkatësisht:

		<b>OBJEKTI: Ambulanca Zall Dajt, Komuna ZallBastar</b>		
<b>Nr</b>	<b>Nr.Art</b>	<b>PERSHKRIMI I PUNIMEVE</b>		

			<b>NJESIA e ofertuar</b>	<b>NJESIA në DT</b>
		<b>A. PUNIME NDERTIMI</b>		
		<b>I. Punime prishje</b>		
2	An	Prishje mur guri ne lartesi	m2	m3

		<b>OBJEKTI: QSH Rubik, Mirdite</b>		
<b>Nr</b>	<b>Nr.Art</b>	<b>PERSHKRIMI I PUNIMEVE</b>		
			<b>NJESIA e ofertuar</b>	<b>NJESIA në DT</b>
		<b>A. PUNIM E NDERTIMORE</b>		
		<b>3. PUNIME SHITRESE/VESHJE DHE SUVATIMI</b>		
9	2.324/b	Plintuza gres importi h=10cm	m2	ml

Ndryshimet e bëjnë ofertën e këtij operatori të pa krahasueshme dhe të pamundur në vendosje në kushte të barabarta me operatorët e tjerë pjesëmarrës në këtë procedurë.

Kjo në zbatim të ligjit Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” neni2 pika d:

*Qëllim i këtij ligji është:*

- të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;
- të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;
- të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;
- të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;

dhe të nenit 3 pika 1 të këtij ligji:

*Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale.*

Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se zotërojnë reputacionin, besueshmërinë dhe përvojën e duhur, për të zbatuar kontratën objekt prokurimi, si edhe janë të detyruar të përgatisin oferta, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit, në mënyrë që edhe vlerësimi të bëhet në përputhje me këtë dokumentacion, pasi ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme.

**Për sa më lart oferta e operatorit S I R E T A 2F shpk nuk kualifikohet.**

- 4. GLAVENICA shpk me NIPT K17710805A dhe adresë Fier Ballsh Lagjja "5 Shkurti", Bulevardi "4 Heronjtë", godina nr.2, apartament nr.3, kati.4 ofertuar me vlerën 54,427,193.00 lekë pa TVSH, me vlerë ofertë të korrigjuar 53,954,113.34 lekë pa TVSH.**

**Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:**

Nga dokumentacioni i dorëzuar nga OE Glavenica Sh.p.k., rezultoi si më poshtë:

Në DST, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, **pika 2.3.7** kërkohet:

**2.3.7.** Të ketë në stafin e punonjesve te pasqyruar në list-pagesa:

punonjës të pajisur me deshmi kualifikimi te sigurimit teknik nga ISHTI (ish –IQT) ose ekuivalente me të, të vlefshme:

min 3 (tre) teknik ndërtimi; min 5 (pese) punonjës elektrikist; min 5 (pese) punonjës hidraulik/mekanik; min 4 (kater) punonjës murator; min 3 (tre) punonjës pllakashtrues; min 3 (tre)

punonjes bojaxhi; min 2(dy) punonjës hidroizolues, min 2 (dy) suvatues; - min 2(dy) punetor d/alumini; - min 2 (dy) punetor cmontimi d/yer, dritare;

Per punonjesit e siperpermendur te paraqiten deshmite perkatese te kualifikimit te sigurimit teknik si dhe kontrata e punes (te vlefshme).

Kriteri konsiderohet i përbushur me paraqitjen e formularit të vetëdeklarimit sipas shtojcës 8 të DST.

Shenim:

Referuar pikës 1, të nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, **i ndryshuar**, ku parashikohet : *“Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla”,* si dhe përcaktimet e pikës 6, të këtij neni, ku parashikohet: **“Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin”.**

Sa më lart, referuar kriterit të përcaktuar në **pikën 2.3.7 të DST** është kërkuar stafi si më sipër, për të cilin duhet të paraqitet deshmitë perkatëse të kualifikimit të sigurimit teknik si dhe kontrata e punës (të vlefshme), si dhe është kërkuar të figurojnë në listëpagesat (e shoqërisë) për periudhën e kërkuar në DST.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar nga operatori ekonomik Glavenica Shpk., në përbushje të kërkesave për kualifikim sipas **pikën 2.3.7**, janë paraqitur kontratat e punës dhe dëshmi të sigurimit teknik, gjithashtu është dorëzuar listëpagesa e sigurimeve shoqërore për periudhën e kërkuar në DST, nga ku rezulton se punonjësit:

1. M.Hodaj është deklaruar në **Shtojcën 8 të DST (Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit)**, me profesion Teknik ndërtimi, ndërkohë në listëpagesë është deklaruar me kodin 5414.02 **Roje**;
2. E.Kociaj është deklaruar në **Shtojcën 8 të DST (Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit)**, me profesion Elektricit, ndërkohë në listëpagesë është deklaruar me kodin 8342.02 **Drejtues Eskavator**;
3. P.Mucaj është deklaruar në **Shtojcën 8 të DST (Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit)**, me profesion Elektricit, ndërkohë në listëpagesë është deklaruar me kodin 8332.06 **Drejtues të makinave të ngjeshjes (rrula)**;
4. A.Mucaj është deklaruar në **Shtojcën 8 të DST (Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit)**, me profesion Elektricit, ndërkohë në listëpagesë është deklaruar me kodin 7115.02 **Karpentier**;
5. A.Grembi është deklaruar në **Shtojcën 8 të DST (Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit)**, me profesion Hidraulik, por ka mospërputhje emrash në kontratën e punës të dorëzuar për këtë punonjës, pasi rezulton të jetë firmosur nga A.Grembi, por në përmbajtje të saj është vendosur emri i një punonjësi tjetër.
6. K.Mucaj është deklaruar në **Shtojcën 8 të DST (Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit)**, me profesion Hidraulik, ndërkohë në listëpagesë është deklaruar me kodin 6114.17 **Punonjës i kualifikuar hortikulture**;
7. A.Qallia është deklaruar në **Shtojcën 8 të DST (Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit)**, me profesion Hidraulik, ndërkohë në listëpagesë është deklaruar me kodin 8342.02 **Drejtues Eskavatori**;

8. T.Molloi është deklaruar në **Shtojcën 8 të DST (Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit)**, me profesion Murator, ndërkohë në listëpagesë është deklaruar me kodin 7411.01 **Elektracist;**
9. B.Beqiri është deklaruar në **Shtojcën 8 të DST (Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit)**, me profesion Murator, ndërkohë në listëpagesë është deklaruar me kodin 8332.14 **Shofer Kamioni;**
10. F.Troka është deklaruar në **Shtojcën 8 të DST (Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit)**, me profesion Pllakashtrues, ndërkohë në listëpagesë është deklaruar me kodin 9214.15 **Punëtor lulishtar;**
11. K.Ziu është deklaruar në **Shtojcën 8 të DST (Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit)**, me profesion Pllakashtrues, ndërkohë në listëpagesë është deklaruar me kodin 8342.03 **Drejtnues fadrome/fadromist;**
12. M.Rama është deklaruar në **Shtojcën 8 të DST (Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit)**, me profesion Bojaxhie, ndërkohë në listëpagesë është deklaruar me kodin 9214.15 **Punëtor lulishtar;**
13. N.Sinaj është deklaruar në **Shtojcën 8 të DST (Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit)**, me profesion Bojaxhi, ndërkohë në listëpagesë është deklaruar me kodin 5414.02 **Roje;**
14. K.Meta është deklaruar në **Shtojcën 8 të DST (Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit)**, me profesion Hidroizolues, ndërkohë në listëpagesë është deklaruar me kodin 9214.15 **Punëtor lulishtar;**
15. A.Belshi është deklaruar në **Shtojcën 8 të DST (Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit)**, me profesion Hidroizolues, ndërkohë në listëpagesë është deklaruar me kodin 9214.15 **Punëtor lulishtar;**
16. A.Meta është deklaruar në **Shtojcën 8 të DST (Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit)**, me profesion Suvatues, ndërkohë në listëpagesë është deklaruar me kodin 9214.04 **Punëtor krasitës bimësh shkurre;**
17. S.Halili është deklaruar në **Shtojcën 8 të DST (Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit)**, me profesion Suvatues, ndërkohë në listëpagesë është deklaruar me kodin 2330.08 **Mësues historie për shkollat e mesme;**
18. A.Hyka është deklaruar në **Shtojcën 8 të DST (Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit)**, me profesion Punëtor duralumini, ndërkohë në listëpagesë është deklaruar me kodin 9214.04 **Punëtor krasitës bimësh shkurre;**
19. A.Sherifaj është deklaruar në **Shtojcën 8 të DST (Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit)**, me profesion Punëtor duralumini, ndërkohë në listëpagesë është deklaruar me kodin 8342.03 **Drejtnues Fadrome;**
20. D.Kucaj është deklaruar në **Shtojcën 8 të DST (Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit)**, me profesion Cmontues dyer dhe dritare, ndërkohë në listëpagesë është deklaruar me kodin 8342.02 **Drejtnues Eskavator.**

Bazuar në praktikën e **Komisionit të Prokurimit Publik vendimi nr. 480/2020 i datës 29.10.2020**, i cili parashikon se: “*KPP gjykon se kriteret e veçanta për kualifikim kanë si synim kryesor që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme.”*



si edhe në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 514, datë 20.09.2017 “Për miratimin e listës kombëtare të profesioneve (LKP), të rishikuar”, i cili parashikon listën kombëtare të profesioneve, të cilët identifikohen me anë të kodeve në listëpagesë.

Sipas **DST Shtojca 7** parashikohet:

### **Shënim për operatorët ekonomik:**

**Shënim:** Në zbatim të pikës 1, të Nenit 26, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, ku parashikohet: “Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla”, si dhe përcaktimet e pikës 6, të këtij neni, ku parashikohet: “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike<sup>1</sup>. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.

Autoriteti/enti kontraktor pranon një dokument të lëshuar nga i njëjti institucion ose palë e tretë dhe që ka të njëjtin informacion me atë të paraqitur në procedurën e zhvilluar në mënyrë elektronike.” Gjthashtu sjellim ne vemendje se:

- Disponimi i kapaciteteve sipas **pikave 2.3.4, 2.3.5, 2.3.6, 2.3.7, 2.3.9, të kapacitetit teknik**, do të dëshmohet nëpërmjet paraqitjes së Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit (shtojca 8) gjatë fazës së ofertimit.
- Autoriteti/enti kontraktor përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, do t’i kërkojë ofertuesit fitues nëpërmjet Sistemit të Prokurimit Elektronik që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet e bëra në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si dhe dokumentet e tjera të kërkuara sipas Shtojcës 8 të DST. Mosparaqitja e dokumentacionit permbushes për keto pika do te jete kusht skualifikimi.
- Autoriteti Kontraktor mund te beje verifikimin e dokumentacionit ne perputhje me vetedeklarimin e bere gjate fazes se ofertimit. **Konstatimi i mosperputhjeve midis Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit dhe dokumentacionit te dorezuar perben kusht skualifikimi.**
- Në cdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

Në Ligjin Nr. 162 datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, **neni 76 “Kriteret detyruese për skualifikim” pika 3 shkronja ë** parashikon:

3. Çdo operator ekonomik skualifikohet nga pjesëmarrja në procedurën e prokurimit nëse është në një nga situatat e mëposhtme:  
ë) operatori ekonomik ka paraqitur deklarata të rreme në dhënien e informacionit të kërkuar për të vërtetuar mungesën e arsyeve për skualifikim ose për plotësimin e kriterëve të përzgjedhjes, ka fshehur një informacion të tillë ose nuk është në gjendje të dorëzojë dokumentet provuese sipas kërkesave të përcaktuara në dokumentet e tenderit;

Pas verifikimit të dokumentacionit të **OE Glavenica Shpk.**, rezulton se nuk përmbush kapacitetet teknike sipas kërkesave të DST dhe LPP, si rrjedhojë operatori **do të skualifikohet.**

5. **K A C D E D J A shpk** me NIPT **K51712017A** dhe me adresë Tirane Rruga Don Bosko, Pallati Meld, Kati i dytë ofertuar me vlerën **55,680,906.90 lekë pa TVSH.**

**Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:**

- Nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur nga ky operator u konstatua se ka ndryshim të njësisë matëse të llogaritjes së cmimit njësi të ofertës ekonomike nga njësia matëse e llogaritjes e publikuar në DT.

Përkatësisht:

		<b>OBJEKTI: Ambulanca Zall Dajt, Komuna ZallBastar</b>		
<b>Nr</b>	<b>Nr.Art</b>	<b>PERSHKRIMI I PUNIMEVE</b>		
			<b>NJESIA e ofertuar</b>	<b>NJESIA në DT</b>
		<b>A. PUNIME NDERTIMI</b>		
		<b>I. Punime prishje</b>		
2	An	Prishje mur guri ne lartesi	m2	m3

		<b>OBJEKTI: Ambulanca Vorrozen</b>		
<b>Nr</b>	<b>Nr.Art</b>	<b>PERSHKRIMI I PUNIMEVE</b>		
			<b>NJESIA e ofertuar</b>	<b>NJESIA në DT</b>
		<b>A. PUNIME NDERTIMI</b>		
		<b>I. Punime prishje</b>		
4	2.37/5a	Transport dheu me auto deri 5.0 km	m2	m3

Ndryshimet e bëjnë ofertën e këtij operatori të pa krahasueshme dhe të pamundur në vendosje në kushte të barabarta me operatorët e tjerë pjesëmarrës në këtë procedurë.

Kjo në zbatim të ligjit Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” neni 2 pika d:

*Qëllim i këtij ligji është:*

- të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;*
- të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;*
- të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;*
- të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;*
- të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;*

dhe të nenit 3 pika 1 të këtij ligji:

*Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe vepronë me transparencë e në mënyrë proporcionale.*

Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se zotërojnë reputacionin, besueshmërinë dhe përvojën e duhur, për të zbatuar kontratën objekt prokurimi, si edhe janë të detyruar të përgatisin oferta, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit, në mënyrë që

edhe vlerësimi të bëhet në përputhje me këtë dokumentacion, pasi ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme.

**Për sa më lart oferta e operatorit K A C D E D J A shpk nuk kualifikohet.**

6. **STERKAJ shpk** me NIPT **J68310708M** dhe adresë Tiranë Njësia Bashkiake Nr. 5, Blv. "Bajram Curri", mbrapa pallateve Agimi, Pallati 7/1B, Kati 2, ofertuar me vlerën **59,045,627.22 lekë pa TVSH.**

**Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:**

- Nga shqyrtimi i dokumentacionit dhe gjatë verifikimit të tij rezulton se inxhinieri **pjesë e stafit kryesor** njëkohësisht drejtues teknik dhe për të cilin është deklaruar se do të jetë gjatë gjithë kohës në kantier është i dypunësuar. **Kjo në kundërshtim me deklaratën e vetë operatorit ekonomik, por edhe në kundërshtim me VKM Nr. 42, datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”.**

Ismail Pervana punësuar në Drejtorinë e Përgjithshme të Objekteve Publike, institucion në vartësi të Bashkisë Tiranë.

Në bazë të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 42, datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi” **Kreu IV, Drejtuesi Teknik i Shoqërisë dhe Papajtueshmëria me Këtë Detyrë**, përcaktohet:

2. **Papajtueshmëritë me detyrën e drejtuesit teknik të shoqërisë së zbatimit Drejtuesit teknik të shoqërisë nuk mund të jenë personat që janë të angazhuar në cdo punë-marrje tjetër publike.**

**Drejtuesi teknik i shoqërisë nuk mund të jetë njëkohësisht i punësuar në dy apo më shumë shoqëri ndërtimi dhe ndalohet të disponojnë licencë për mbikëqyrje e kolaudim të punimeve të zbatimit**

**Për sa më lart, oferta e operatorit STERKAJ shpk nuk kualifikohet.**

7. **PEPA GROUP shpk** me NIPT **L42215009L** dhe me adresë Tiranë Kashar Autostrada Tiranë Durrës km 6, Zona Kadastrale nr.2105, Nr Pasurie 1168/13, ofertuar me vlerën **61,207,869.93 lekë pa TVSH.**

**Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:**

- Në dokumentacionin e paraqitur nga ky operator lidhur me plotësimin e kapaciteteve sipas **pikës 2.3.9, të kapacitetit teknik**, duhej të dëshmoj nëpërmjet paraqitjes së **Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit (shtojca 8)** gjatë fazës së ofertimit, për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik.

Nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar nga ky operator, **rezultoi të mos jetë përcaktuar në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit (Shtojca 8 e DST) sasia e mjeteve/pajisjeve teknike (të cilat i ka në pronësi ose me qira)**, duke e bërë të pamundur verifikimin e plotësimin apo jo të kriterit të **DST pika 2.3.9 e Shtojcës 7**, ku kërkohet të përcaktohet sasia si më poshtë:

<i>Motogjenerator me fuqi deri 5kva</i>	<i>6 copë</i>	<i>Pronësi ose me qira</i>
<i>Matrapik</i>	<i>6cope</i>	<i>Pronësi ose qira</i>
<i>Nivelues betoni</i>	<i>2 cope</i>	<i>Pronësi ose qira</i>
<i>ekskavator goma ose zinxhir 0.25 m<sup>3</sup></i>	<i>1 cope</i>	<i>Pronësi ose me qira</i>

<i>Depozita uji 1.000 lt</i>	<i>6 cope</i>	<i>Pronesi ose me qira</i>
<i>Prerese pllakash</i>	<i>6 cope</i>	<i>Pronesi ose me qira</i>
<i>Pompe suvatimi</i>	<i>6 cope</i>	<i>Pronesi ose me qira</i>

Nërkohë në Shtojcën 8 të dorëzuar në SPE, operatori ekonomik nuk i ka përcaktuar sasi të. **Operatori ekonomik pjesëmarrës në procedurën e prokurimit është prima-facia i interesuar për procedurës e për rrjedhojë është përgjegjësia e këtij të fundit plotësimi më përgjegjës dhe me saktësi sipas kërkesave të vendosura nga Autoriteti kontraktor, kritere për të cilat operatori nuk ka pasur pretendime në fazën e ofertimit.**

Në bazë të LPP, Neni 92, Shqyrtimi i ofertave, pika 1 citohet:

*1. Autoriteti ose enti kontraktor, kur e shikon të arsyeshme, u kërkon ofertuesve sqarime për ofertat e tyre, për shqyrtimin, vlerësimin dhe krahasimin sa më të drejtë të këtyre ofertave. Pa cenuar dispozitat e parashikuara në këtë ligj, nuk duhet të kërkohej, të ofrohet ose të lejohet asnjë ndryshim në përmbajtjen e ofertës, përfshirë ndryshimet në vlerë apo ndryshime që synojnë të kthejnë një ofertë të pavlefshme në të vlefshme.*

Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se zotërojnë reputacionin, besueshmërinë dhe përvojën e duhur, për të zbatuar kontratën objekt prokurimi, si edhe janë të detyruar të përgatisin oferta, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit, në mënyrë që edhe vlerësimi të bëhet në përputhje me këtë dokumentacion, pasi ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme.

**Për sa më lart oferta e operatorit “PEPA GROUP” shpk nuk kualifikohet.**

**8. INA shpk me NIPT J61814009W dhe me adresë Tiranë Rruga Besim Imami, Myslym Shyri, Mbrapa Karburantit ofertuar me vlerën 61,246,704.00 lekë pa TVSH.**

**Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:**

- Nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar nga ky operator ekonomik, lidhur me Formularin e Sigurimit të Ofertës, rezulton të mos të jetë sjellë në përputhje me kërkesat e parashikuara në DST, konkretisht:

Në DST kërkohej:

**3.2 Periudha e vlefshmërisë së ofertës: 180 (shprehur në ditë)**

Operatori ekonomik në Formularin e Sigurimit të Ofertës të dorëzuar, **si periudhë vlefshmërie të sigurimit është afati prej 150 ditë, dhe jo 180 ditë sipas kërkesave të DST.**

Kjo në kundërshtim dhe me **pikën 3 të nenit 30 “Sigurimi i ofertës”** të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, e cila citon:

***3. Autoriteti/enti kontraktor duhet të specifikojë në dokumentet e tenderit vlerën e sigurimit të ofertës, e cila është sa 2% e vlerës së fondit limit. Në dokumentet e tenderit duhet të parashikohet një periudhë vlefshmërie, bazuar në kohëzgjatjen e mundshme të***

procedurës. Sigurimi i ofertës duhet të jetë i vlefshëm gjatë gjithë kësaj periudhe.

- Nga shqyrtimi i dokumentacionit dhe gjatë verifikimit të tij rezulton se inxhinieri **pjesë e stafit kryesor** njëkohësisht drejtues teknik është i dypunësuar. Kjo në kundërshtim me **VKM Nr. 42, datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”**.

Telemak Masho punësuar në Drejtorinë e Shërbimit Spitalor, institucion në vartësi të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

Në bazë të **Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 42, datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi” Kreu IV, Drejtuesi teknik i shoqërisë dhe papajtueshmëria me këtë detyrë**, përcaktohet:

2. **Papajtueshmëritë me detyrën e drejtuesit teknik të shoqërisë së zbatimit Drejtuesit teknikë të shoqërisë nuk mund të jenë personat që janë të angazhuar në çdo punë-marrje tjetër publike.**

**Drejtuesi teknik i shoqërisë nuk mund të jetë njëkohësisht i punësuar në dy apo më shumë shoqëri ndërtimi dhe ndalohet të disponojnë licencë për mbikëqyrje e kolaudim të punimeve të zbatimit.**

**Për sa më lart oferta e operatorit INA shpk nuk kualifikohet.**

- 9. **JUNIK shpk me NIPT J68007522L dhe me adresë Lezhë Lagjja SMT, Ndërtesë 2-Katëshe, kati 2, pranë Drejtorisë Shërbimit Pyjor Lezhë, ofertuar me vlerën 63,116,553.00 lekë pa TVSH.**

**Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:**

- Nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur nga ky operator u konstatuan ndryshime të njësisë matëse të llogaritjes së cmimit njësi të ofertës ekonomike nga njësia matëse e llogaritjes e publikuar në DT.

Perkatësisht:

		<b>OBJEKTI: Ambulanca Zall Dajt, Komuna ZallBastar</b>		
Nr	Nr.Art	<b>PERSHKRIMI I PUNIMEVE</b>		
			<b>NJESIA e ofertuar</b>	<b>NJESIA në DT</b>
		<b>A. PUNIME NDERTIMI</b>		
		<b>I. Punime prishje</b>		
2	An	Prishje mur guri ne lartesi	m2	m3
4	An	Heqje dyer	m1	m2
6	An	Heqje dritare	m3	m2

		<b>OBJEKTI: Ambulanca Vorrozen</b>		
Nr	Nr.Art	<b>PERSHKRIMI I PUNIMEVE</b>		

			<b>NJESIA e ofertuar</b>	<b>NJESIA në DT</b>
		<b>A. PUNIME NDERTIMI</b>		
		<b>I. Punime prishje</b>		
4	2.37/5a	Transport dheu me auto deri 5.0 km	m2	m3

		<b>OBJEKTI: Ambulanca e Fshatit Bicaj (Objekti ekzistues)</b>		
<b>Nr</b>	<b>Nr.Art</b>	<b>PERSHKRIMI I PUNIMEVE</b>		
			<b>NJESIA e ofertuar</b>	<b>NJESIA në DT</b>
		<b>B. INSTALIMET HIDROSANITARE</b>		
		<b>I. Punime hidrosanitare</b>		
7	AN proj	FV kontra valvol 1/2" ne hyrje te depozites se ujit	ml	cope

		<b>OBJEKTI: QSH Lekbibaj, Tropoje</b>		
<b>Nr</b>	<b>Nr.Art</b>	<b>PERSHKRIMI I PUNIMEVE</b>		
			<b>NJESIA e ofertuar</b>	<b>NJESIA në DT</b>
		<b>A. Punime Ndertimi</b>		
		<b>1. Punime Catie dhe Tarrace</b>		
3	An pro	Prishje tavane me derase ose materiale te tjera dhe riberja me karton xhes të zakonshëm	m3	m2

Ndryshimet e bëjnë ofertën e këtij operatori të pakrahasueshme dhe të pamundur në vendosje në kushte të barabarta me operatorët e tjerë pjesëmarrës në këtë procedurë.

Kjo në zbatim të ligjit Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” neni2 pika d:

*Qëllim i këtij ligji është:*

- e) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;*
- f) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;*
- g) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;*
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;*
- h) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;*

dhe të nenit 3 pika 1 të këtij ligji:

*Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale.*

- Së dyti në DST është përcaktuar se:

*“2.3.6 Operatori ekonomik pjesmarres duhet te deklaroje inxhinierin e ndertimit, qe do te jene ne kantier sipas grafikut te punimeve:*

- Per rajonin Tirane: 1 inxh.ndertimi;*
- Per rajonin Shkoder: 1 inxh.ndertimi;*

*Per sejcilin prej ketyre inxhinierëve te kantierit sipas pikes 2.3.6 duhet te paraqiten kontratat e punes brenda afatit te vlefshmerise se ketij objekti, diplomat dhe cv.”*

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar nga ky operator, nëpërmjet Shtojcës 8 të DST, rezulton që ky operator nuk i ka deklaruar inxhinierët sipas kërkesave të vendosura në DST në pikën 2.3.6 të sipërpërmendur.

**Operatori ekonomik pjesëmarrës në procedurën e prokurimit është prima-facia i interesuar për procedurës e për rrjedhojë është përgjegjësia e ketij të fundit plotësimi më përgjegjesi dhe me saktësi sipas kërkesave të vendosura nga Autoriteti kontraktor, kritere për të cilat operatori nuk ka pasur pretendime në fazën e ofertimit.**

Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se zotërojnë reputacionin, besueshmërinë dhe përvojën e duhur, për të zbatuar kontratën objekt prokurimi, si edhe janë të detyruar të përgatisin oferta, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit, në mënyrë që edhe vlerësimi të bëhet në përputhje me këtë dokumentacion, pasi ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme.

**Për sa më lart oferta e operatorit JUNIK shpk nuk kualifikohet.**

**10. DON JURGE shpk me NIPT K33005405Q dhe adresë Fier LEVAN, pa ofertë ekonomike.**

Operatori ekonomik nuk ka paraqitur asnjë dokumentacion dhe as ofertë ekonomike **dhe si rrjedhojë nuk kualifikohet.**

\* \* \*

Janë kualifikuar si të suksesshme ofertat e mëposhtme:

- 1. COMPANY RIVIERA 2008 shpk me NIPT K81716011V dhe me adresë Tirane Kamëz Rruga Nacionale Kamëz-Fushë Krujë, Kthesa e Valiasit Nr.1, në zonë kadastrale 2066, Nr.Pasurie 62/35, ofertuar me vlerën 55,835,085.00 lekë pa TVSH.**
- 2. AVDULI shpk me NIPT J66703306O dhe adresë Vlorë Lagjja 10 Korriku, Rruga Perlat Rexhepi, Objekt 3-katesh nr.4, Kati 1, ofertuar me vlerën 60,389,001.00 lekë pa TVSH, me vlerë ofertë të korrigjuar të ofertës 59,763,296.67 lekë pa TVSH.**
- 3. AURORA KONSTRUKSION shpk me NIPT K02017003I dhe me adresë Tiranë Bulevardi Zogu i Parë, Pallati pranë Fakultetit të Shkencave, ofertuar me vlerën 62,915,725.00 lekë pa TVSH.**

**Shënim: Sqarojmë se oferta e paraqitur nga OE AURORA KONSTRUKSION shpk, është kualifikuar si në lotin 1 dhe lotin 2 të kësaj procedure, pasi i ka përmbushur kriteret e kualifikimit për secilin prej këtyre loteve, por nuk mund të shpallet fitues në të dyja lotet pasi nuk përmbush kriteret e kualifikimit në mënyrë kumulative për to.**

**PJESMARRJA NË MË SHUMË SE NJË LOT:**

- Nese nje operator ekonomik konkuron ne me shume se **1 lot** te kesaj procedure prokurimi atehere ai duhet te zoteroje kapacitetet e nevojshme dhe te mjaftueshme per te realizuar objektin e procedures se prokurimit, pra te gjitha loteve se bashku. Ne kete kuptim edhe kriteret e vecanta per kualifikim si: pika 2.1.1, pika 2.3.1 të kapacitetit teknik si dhe

kategorite e licensave, nr. i punonjesve, i mjeteve, etj. duhet te plotesohen nga operatori ekonomik ne varesi te **shumatores së loteve për të cilat konkurron**.

- Vleresimi mbi kategorite e licences, do te behet me radhe per secilin lot, duke pasur parasysh qe vlera e punimeve qe ka ofertuesi ne proces (perfshire lotin/lotet per te cilet eshte mbyllur vleresimi dhe eshte shpallur fitues ne kete procedure) nuk tejkalon vleren e punimeve sipas kategorive te licences profesionale te ofertuesit.
- Persa i takon licensave, te kihet parasysh qe sipas loteve ku oferton te paraqese kategorite e licensave sipas tabelës së mëposhtme:

<b>LOT 1 + LOT 2</b>	<i><b>N.P. 1</b> Punime gërmimi në tokë</i>	<i><b>N.P. 3</b> Rikonstruksion dhe mirëmbajtje godinash civile e industriale, veshje fasadash</i>	<i><b>NP-7</b> Ujesjellësa, gazsjellësa, vajsjellësa, vepra kullimi e vadtje</i>	<i><b>NS-1</b> Punime per prishje te ndertimeve</i>	<i><b>NS 2-</b> Impiante H/sanitare</i>	<i><b>NS 4-</b> Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniture me materiale druri, plastik, metalik dhe xhami dhe rifiniture të natyrës teknike ndërtuese)</i>	<i><b>N.S- 14</b> Impiante të brendshme elektrike, telefonike, radiotelefoni TV</i>
	<b>A</b>	<b>B</b>	<b>A</b>	<b>A</b>	<b>A</b>	<b>B</b>	<b>A</b>

*Klasifikimi fitues do të bëhet sipas lotit të radhës (1-2). Nëse OE tërhiqet nga oferta potenciale fituese, sipas lotit të rradhës, atëherë ai penalizohet për tu shpallur fitues në lotin tjetër pasardhës, ku mund të jetë pretendent.*

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë **COMPANY RIVIERA 2008 Shpk., me NIPT K81716011V dhe me adresë Tirane Kamëz Rruga Nacionale Kamëz-Fushë Krujë, Kthesa e Valiasit Nr.1, në zonë kadastrale 2066, Nr.Pasurie 62/35**, se oferta e paraqitur (vlera pa tvsh) prej **55,835.085.00** [pesëdhjetë e pesë milion e tetëqind e tridhjetë e pesë mijë e tetëdhjetë e pesë] Lekë/ totali i pikëve të marra [\_\_\_\_\_] është identifikuar si Oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë **AK/MSHMS** sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 5 ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose nuk dorëzon sigurimin e kontratës brenda afatit përfundimtar tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj) dhe kontrata do t'i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej [vlera përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra], siç parashikohet në nenin 83 të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.



Ankesat: *(vendimi përfundimtar për trajtimin e ankesës/ave nr. datë)* – Nuk ka.

**TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR**

**JOANA DURO**